



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 374/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkim Ademaj në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, për shkak të mbajtjes së tubimit politik pa paralajmërim, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Bashkim Ademaj në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), dega në Istog, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 500 (pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.10.2013, nga Bashkim Ademaj (ZLKZ) dega në Istog, në të cilën pretendohet se me datë 20.10.2013, duke filluar nga ora 16:00 dhe duke përfunduar në ora 17:00, në shtëpinë private të Shefqet Zogaj në fshatin Kaliqan, komuna e Istogut, është mbajtur tubim politik i pa lajmëruar. Në këtë tubim sipas parashtruesit të ankesës, kanë marrë pjesë 20 persona, programin e kësaj partie e ka shpalosur kandidatja për kryetare të komunës së Istogut, Donika Kadaj – Bujupi. Sipas parashtruesit të ankesës tubimi ka përfunduar i qetë. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës raportin policor.

Në raportin policor theksohet se në shtëpinë private Shefqet Zogaj që gjendet në fshatin Kaliqan KK Istog, me datën 20.10.2013 duke filluar nga ora 16:00 dhe duke mbaruar në ora 17:00, është mbajtur tubim politik parazgjedhorë i pa lajmëruar i subjektit politik AAK, në të cilin tubim kanë marrë pjesë rreth 20 persona simpatizant të kësaj partie, kurse programin e kësaj partie e ka shpalosur kandidatja për kryetare të komunës së Istogut Donika Kadaj – Bujupi, dhe se tubimi ka përfunduar i qetë dhe pa asnjë incident.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 30.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 31.10.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i mori përgjigjen e kërkuar nga

subjekti politik AAK, në të cilën theksohet se tubimi që është mbajtur me datë 20.10.2013 në fshatin Kaliqan KK Istog, ka qenë takim privat në shtëpinë në private të Shefqet Zogaj ashtu siç theksohet në ankesë. Subjekti politik AAK, në përgjigjen në ankesë thekson se parashtuesi i ankesës Bashkim Ademaj ka dorëzuar ankesë në PZAP me datë 29.10.2013, për të cilën ankesë, ky subjekt pretendon se është bërë jashtë afateve të përcaktuara.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të bazuara pasi që neni 4.2 i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, lidhur me Fushatën Zgjedhore dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike, theksohet se subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë dhe të mbajë një tubim publik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore duhet që të Zyrta i Lartë Komunal i Zgjedhjeve i asaj Komune (ZLKZ), të dorëzojë formularin e plotësuar të Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik (FNJMTP) me së voni shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara. Prandaj PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën ligjore konstatoi se subjekti politik AAK, nuk e ka njoftuar organin kompetent komunal, në këtë rast ZLKZ, për mbajtjen e këtij tubimi, andaj mbi këtë bazë dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 dhe 120.1.c të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 374/2013 më datën 01.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*